Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të burimeve gjenetike, specieve dhe ekosistemeve. Njihet gjithashtu si një vatër e rëndësishme biodiversiteti në Evropë me një diversitet të lartë ekosistemesh dhe habitatesh si dhe me një numër të madh llojesh sub-endemike, endemike, të rralla dhe të rrezikuara globalisht prezente në territor. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethegjere dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore. Ky diversitet i atribuohet pozicionit gjeografik të vendit si edhe karakteristikave të relievit, tokës, klimatike, hidrologjike dhe gjeologjike. Terreni malor i kombinuar me shkëmbinj të thepisur ka krijuar kushte ideale për mirmbajtjen dhe mbrojtjen e një sërë specimesh relikte, disa prej të cilave endemike ose sub-endemike.

Gjendja e biodiversitetit prezantohet me të dhënat e monitorimit të llojeve bimore e shtazore dhe rritjen e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura e monitorimin e biodiversitetit brënda tyre. Moment i rëndësishëm në kuadrin ligjor për biodiversitetin është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 31 datë 20.01.2016 “Për Miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit në këtë dokument të rëndësishëm jepen planet konkrete të veprimit dhe strategjia që do të ndiqet për mbrojtjen e tij. Shqipëria gjendet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit dhe karakterizohet nga një klimë mesdhetare në ultësira dhe lugina, si dhe kontinentale e të ftohtë në lartësitë veriore dhe lindore. Edhe pse një vend i vogël, Shqipëria, shquhet për larmi të peizazheve e atyre biologjike dhe radhitet ndër vendet me biodiversitet të lartë në Evropë. Sipërfaqja e Shqipërisë, parë në aspektin gjeofik zik dominohet nga kodra dhe male në pjesën lindore e veriore dhe zonën e ulët në pjesën perëndimore. (Rap. për gjëndjen e mjedisit 2019 nga AKM)

Pjesë me rëndësi në Republikën e Shqipërisë është “Ultësira perëndimore”, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga liqeni i Shkodrës në veri deri në qytetin e Vlorës në jug. Veç daljes në det, kjo ultësirë përshkohet nga veprimtaria e lumenjve kryesorë, të cilët përgjithësisht rrjedhin nga lindja në perëndim. Bregdeti shqiptar është 476 km i gjatë, ndërsa deti Adriatik dhe Jon kanë një ndikim të madh mbi klimën, florën dhe faunën e vendit. Zona veriore e Shqipërisë ka një reliev malor dhe karakterizohet nga një diversitet i formacioneve shkëmbore që nga koha e Paleozoikut. Pjesa më e madhe e vendit është zonë malore, ndërsa lartësia ulet duke fi lluar nga lindja në perëndim të vendit dhe kjo përcakton kushtet e klimës, tokës dhe vegjetacionit. i gjithë peizazhi i sotëm është rezultat i zhvillimit gjeologjik gjatë lëvizjeve tektonike dhe neotektonike.

Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut, si: lagunat, sistemet ligatinore, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet dhe hygrophilet. Komunitetet bregdetare dhe infralitorale me origjinë mesdhetare përgjatë bregdetit shkëmbor janë mjaft të ndryshme dhe të ruajtura mirë. Liqenet dhe lumenjtë janë, gjithashtu, të rëndësishme për larminë biologjike dhe peizazheve të vendit. *(Rap. për gjëndjen e mjedisit 2019 nga AKM)*

### ***Të dhëna të përgjithshme për biodiversitetin***

Në Shqipëri hasen përafërsisht 7233 grupime bimore (duke përfshirë fi eret, kërpurdhat, likenet, myshqet dhe algat) ssi dhe 5438 lloje të faunës së egër (duke përfshirë shpezët, gjitarët, peshqit, insektet, molusqet etj). Në vendin tonë takohen përafërsisht 32% e fl orës evropiane, kurse pyjet e lartë tek ne përbëjnë një habitat të rëndësishëm për gjitarët si psh. ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), si dhe shumë lloje shpezësh. Komuniteti i pasur i gjallesave detare është një tregues i përqindjes së lartë i ruajtjes dhe cilësisë së këtyre komuniteteve në vendin tonë. Për vite me rradhë janë hasur afërsisht 70 lloje shpendësh ujorë me një popullatë të përafërt prej 180.000 individësh gjatë sezonit dimëror. Në Shqipëri takohen rreth 91 lloje që rrezikohen në shkallë globale dhe këtu futen: pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), bretkosa shqiptare (*Pelophylax shqipericus*) si dhe bliri (*Acipinser sturio*), lloje për të cilat vendi ynë është areal me rëndësi të veçantë.

**Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura Mjedisore**

Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura janë shpallur, me VKM – të përkatëse, bazuar në Ligjin nr.8906 “Për Zonat e Mbrojtura”, datë 06.06.2002, (të ndryshuar) dhe me hyrjen në fuqi të ligjit 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”.

*Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive*


Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor	2	I	4 800
2	Park Kombëtar	14	II	230,707. 2558
3	Monument Natyre	723	III	3 470.0
4	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	25	IV	169,275. 42
5	Peizazh i Mbrojtur	6	V	97,333. 639
6	Zonë e Mbrojtur e Burimeve Natyrore të Menaxhuara/me përdorim të shumëfishtë	4	VI	18, 245.0
	<b>Totali</b>	<b>776</b>		<b>523,831. 31</b>

Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura mjedisore përfaqësohet nga numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura që është 776 (duke përfshirë edhe monumentet e natyrës), dhe zë një sipërfaqe prej më shumë se 523,831 hektarësh ose rreth 18 % të territorit të Shqipërisë. Në këtë shifër përfshihen edhe territoret bregdetare, si dhe zona detare e Sazan-Karaburunit. Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura është bërë në mënyrë të konsiderueshme që nga strategjia e plani i veprimit të biodiversitetit, të vitit 2000. Duke nisur nga viti 2005 numri i zonave të mbrojtura është rritur më shumë se dy herë, nga 5% në më shumë se 18 %. Harta dhe të dhënat kryesore për ZM-të janë paraqitur respektivisht në anekset 8 dhe 9. Rrjeti aktual i zonave të mbrojtura përfshin 119.401 ha sipërfaqe bregdetare dhe 13.261 ha sipërfaqe detare. Zona e parë detare e mbrojtur në Shqipëri është shpallur në prill të vitit 2010, Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Në listën Ramsar të ligatinave me rëndësi I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura, që përfshin aktualisht 18% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së, në gjashtë kategori kryesore: ndërkombëtare, si habitate ujore me rëndësi për shpendët e ujit janë: 1) Laguna e Karavastasë; 2) Kompleksi ligatinor i Butrintit; 3) Liqeni i Shkodrës dhe Kompleksi ligatinor i lumit Buna; dhe 4) liqenet Zona e Prespës, e shpallur si zona e 4-t Ramsar në Shqipëri, me VKM-në nr. 489, datë 13.6.2013. Shtojca 10 tregon vendndodhjen e zonave

Ramsar në hartën shqiptare. Konventa për ligatinat hyri në fuqi për Shqipërinë, më 29 shkurt të vitit 1996. Shqipëria aktualisht ka 4 zona të përcaktuara si ligatina me rëndësi ndërkombëtare, me një sipërfaqe prej 98.181 hektarësh. Zona e Liqenit të Prespës, duke përfshirë dhe Liqenin e Ohrit u propozua, në vitin 2013, si Rezerva e Parë Biosferike për Shqipërinë. Këshilli Internacional i Koordinimi të Programit të UNESCO-s në një seancë të mbajtur në Jönköping-Suedi, më 11.6.2014 (biosfera dhe njeriu) miratoi propozimin për të quajtur rajonin e Ohrit dhe të Prespës si një rezervë ndërkufi tare biosferë.

Vlen për tu theksuar sic vihet re dhe nga grafi ku i mëposhtëm se në përdorimin e territorit për Zonat e Mbrojtura mbizotërojnë ekosistemet pyjore, vecanërisht në Parqet Kombëtare që gëzojnë statusin e shkallës së dytë të mbrojtjes. Pyjet te konsideruara si shfaqja me e larte e biodiversitetit zene rreth 45% te gjithe territorit. (Rap. për gjëndjen e mjedisit 2019 nga AKM)

Grafiku i perdorimit të territorit për të gjitha kategoritë e ZM.



### **Llojet e kërcënuara të Faunës së Egër në Shqipëri**

Sipas VKM nr.31, datë 20.1.2016, anekset nr.5 dhe nr.6, përmbajnë Listën e gjitareve dhe shpendëve të përfshirë gjithashtu në listën e kuqe (2013), Kjo liste përmbledh 165 lloje me status mbrojtje të kategorive sipas IUCN: Administrata e Zonave të Mbrojtura ka kryer për vitin 2019 censusin kombëtar të shpendeve ujore dimërues, si dhe inventarizimin e faunes se eger ne territoret e zonave te mbrojtura.

Vrojtimi dhe numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimërues (International Eaterbird Census), në Shqipëri u organizua në janar 2019, me përfshirjen e Administratave të Zonave të Mbrojtura në të 12 qarqet, me mbështetjen Projektit NaturAL. Censusi i vitit 2019 mbuloi 26 ligatina (lumenj, liqene, rezervuare, ekosisteme bregdetare etj) në të gjithë Shqipërinë. Për vitin 2019 në total u regjistruan 69 lloje shpendësh me një numër total individësh prej 146 395. Llojet më shpesh të gjetura ishin: bajzat (*Fulica atra*) të cilat zinin rreth 55.44% të numrit total të individëve të numëruar. Disa lloje të tjera, me perfaqesim të lartë ishin: Rosa Kryekuqe e madhe (*Maraca Penelope*), Rosa kërrë (*Anas crecca*), Pulëbardha e zakonshme (*Croicocephalus ridibundus*) Në Liqenin e Shkodrës, ndjekur nga Divjakë – Karavastaja dhe Prespa e Madhe, u regjistrua numri më i lartë me 35 358 individë të shpendeve dimeronjes. Megjithatë përse i përket indeksit të biodiversitetit (balanca midis numrit të individëve dhe numrit të llojeve), Divjakë – Karavastaja mban numrin më të lartë, me 51 lloje.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), është institucionalizuar me VKM nr.102, datë 04.02.2015, si strukturë funksionale e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit. Kjo Agjenci që nga 6-mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim është përfshirë në kryerjen e punës, për ndjekjen permanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim. (*Rap. për gjëndjen e mjedisit 2019 nga AKM*).

### **Ndikimet dhe Masat**

Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendesimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndersjellë dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotësi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përberësve të mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

#### **Mbrojtja e përbërësve të mjedisit klasifikohet në:**

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujërave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky projekt do të ndërtohet në sipërfaqen ujore të plazhit të Golemit, ku pista që do të ndërtohet ndodhet 60 metra larg nga bregu i detit.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit.
- ❖ Në fazën e funksionimit.

Rendesi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime ta pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

**Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:**

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
  - ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
  - ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
  - ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
  - ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuara.
- Të gjithë ndërhyrjet në mjedis që do të ndodhin në zonën e prekur nga Plani do të duhet të respektojnë një sërë udhëzuesish për të siguruar që mjedisi të ruajë karakteristikat e tij të identitetit si një vend ku takohen disa njësi peizazhi; ai produktiv rural, peisazhi i lidhur me linjat e ujit që në thelb, në shprehjen e tij më spontane është breg-liqenor dhe peisazhi i formuar nga njeriu. Këto udhëzime, të ndara në familje të ndryshme të mjeteve të projektimit, duhet të ndihmojnë për të mbrojtur dinamikën dhe metabolizmin e zonës dhe të lejojnë të vazhdojë të funksionojë në mënyrë të njëtrajtshme dhe në rast transformimi.

Cdo veprimtari e zhvilluar nga aktiviteti i njeriut ka ndikim në mjedis dhe në zonën që është propozuar zhvillimi dhe ndërhyrja. E rëndësishme është që për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim. Kjo për të arritur garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ndryshimet e propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vorë lidhen kryesisht me ndryshimin e sipërfaqes së njësisë dhe llojin e investimeve të lejura në këto njësi. Nga vlerësimi i ndryshimeve të propozuara nuk priten të ketë ndryshime të llojit në madhësi të madhe dhe nuk pritet të ketë shumë ndikime.

Lloji i projekteve të propozuara përfshijnë investime në stukturat me funksion si shërbime banimi, akomodimi, argëtimi, tregtare, biznesi, panairë etj.

Njësitë e propozuara për zhvillimin e projekteve të propozuara përfshihen në zona urbane dhe ka prani të investimeve të së njëjtës tipologji me llojet e investimeve që lejohen të zhvillohen sipas ndryshimeve të propozuara në Plan.

Për sa u përket sektorëve mjedisore, asnjë veprim projektues apo menaxhues parashikuar nga Plani nuk gjeneron ndikime negative kumulative apo domethënëse.

Zonat e propozuara nuk bëjnë pjesë në asnjë kategori të zonave të mbrojtura dhe nuk mbartin vlera kulturore dhe historike për vendin.

Zonat për ndryshimet e propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor nuk çënojnë në peisazhin dhe integritetin e mjedisit, vihet re mungesë e mjediist natyrore me florë dhe bimësi të vecantë, në këtë zona prania e faunës është shumë ulët, thuajse është inekzistente.

Vlen të theksohet se për cdo projekt që do të zhvillohet në të ardhmen, shoqëritë investuese do të bëjnë studimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), e cila siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zonës. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

### ➤ **Identifikimi i ndikimeve të mundshme mjedisore**

#### **Toka**

- Ndërhyrje në toka për shkak të ndërtimeve dhe zhvillimeve në infrastrukturë;
- Administrimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruar nga aktivitetet e ndërhyrjeve infrastrukturore

#### **Mbetjet**



- Rritja e gjenerimit të mbetjeve, kryesisht të mbetjeve inerte si rezultat i aktiviteteve infrastrukturore;
- Menaxhim i pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të mbetjeve urbane dhe inerte të gjeneruara;
- Kapacitet i pamjaftueshëm në mirë-menaxhim dhe administrimin e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimi i aktiviteteve të parashikuara në Plan.

### **Airi**

- Emetimi i ndotesve gjatë zhvillimit të aktiviteteve të parashikuara në Plan;
- Rritja e nivelit të pluhurit dhe grimcave në ajër gjatë punimeve dhe aktiviteteve infrastrukturore;

### **Zhurma**

- Rritja e nivelit të zhurmave gjatë ndërtimeve dhe shfrytëzimit të infrastrukturës përkatëse;

### **Mjedisi natyror**

- Ndikim në integritetin dhe funksionimin e mjedisit natyror;
- Ndikime në tipologjinë dhe cilësinë e vecorive natyrore.

### **Masat zbutëse**

#### ***Zhurmat dhe vibrimet***

Zhurmat që mund të gjenerohen janë kryesisht nga prania e mjeteve të transportit të cilat do të bëjnë transportimin e materialeve të nevojshme për fazën e punimeve, nga përdorimi i pajisjeve të rënda të nevojshme për realizimin e procesit të ndërtimit.

Mjetet e transportit do të qarkullojnë në orare të përshtatshme dhe të lejuara në zbatim dhe konform rregullave e legjislacionit ligjor në fuqi, për të shmangur në maksimum shqetësimin e banorëve të zonës përreth. Nëse ndodh që të ketë prani të lartë të nivelit të zhurmave, punëtorët do të pajisen me masa mbrojtëse.

#### ***Shkarkimet në ajër***

Një nga ndikimet e mundshme të identifikuara në mjedis si pasojë e procesit të ndërtimit të projektit të propozuar është ndikimi në cilësinë e ajrit në zonën ku do të zhvillohet ndërtimi.

Shkarkimet në ajër priten të vijnë nga mjetet e transportit të cilët do të bëjnë të mundur transportimin e lëndës së parë dhe materialeve të tjera ndihmëse, të domosdoshme për zhvillimin e punimeve në ndërtimin e objekteve të banimit. Në momentin e shkarkimit të lëndës së parë, makinat e transportit do të jenë të fikura, në këtë mënyrë shkarkimet në ajër do të jenë në nivele sa më të ulëta.

Gjatë fazës së gërmimeve për hapjen e themeleve pritet të ketë një rritje të lehtë të gjenerimit të pluhuravë në ajër, duke ndikuar në cilësinë e ajrit të zonës.

Ndikimet në cilësinë e ajrit do të jenë pezente për një periudhë kohore të shkurtër dhe do të jenë të pranishme për aq kohë sa do të zgjasin edhe punimet.

Monitoirmi i cilësisë së ajrit në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë zonën që përfshihet në Plan.

Koordinimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike.

Kufizimi i shpejtësisë së impianteve të lëvizshme në rrugë.

Kontrrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve sidomos gjatë sezonit të verës, ku ka edhe rritje të numrit të turistëve.

Mirëmbajtje në mënyrë të rregullt të sipërfaqeve rrugore për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur ngritjen e pluhrave.

### ***Mbetjet***

Mbetjet inerte që do të gjenerohen gjatë fazës së punimeve, do të grumbullohen dhe do të largohen në mënyrë periodike nga shoqëria ndërtuese në vendet e përcaktuara nga Pushteti Vendor. Për menaxhimin e mbetjeve inerte do të mbahet në vëmendje dhe do të zbatohen kërkesat e VKM Nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Mbetjet të cilat mund të krijohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve do të grumbullohen dhe do të largohen cdo ditë në venddepozitimet e përcaktuara nga Pushteti Vendor.

### ***Ndryshimet klimatike***

Projektet specifike të Planit duhet të hartohen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë një përdorim efektiv të burimeve, që do të thotë se ndjeshmëria e infrastrukturës së parashikuar ndaj ndryshimeve klimatike; fatkeqësive natyrore duhet të vërehet sic duhet. Në planifikimin e infrastrukturës duhet të merren në konsideratë masa nga vlerësimet e

rreziqeve, të cilat do të rrisin elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrën e duhur, vecanërisht në lidhje me reshjet, përmbytjet, temperaturat e larta, thatësirat etj.

### ***Mjedisi Natyror***

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, të merren parasysh:

- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Të ruhet integriteti natyror i mjedisit dhe biodiversitetit;
- Të sigurohet që projektet dhe strukturat e reja që do të implentohen, të ruajnë integritetin në mënyrë të përshtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formën, madhësinë, dhe sistemimin e objektit dhe zonës përreth tij).

### **Plani i Monitorimit**

Sistemi i monitorimit të ndikimit në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Planit, është një metodë shumë efikase për një monitorim sa më të mirë të mjedisit. Monitorimi i ndikimeve në mjedis është shumë i rëndësishëm për zbatimin e Planit dhe në përputhje me Ligjin 91/2013, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim në kohë ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme.

Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversitetin, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Për çdo sektor mjedisor duhet të monitorohen indikatorët përkatës, duke përcaktuar parametrat mjedisore dhe frekuenca e monitorimit të tyre.

Sistemi i monitorimit duhet të përbëhet nga stacionet e monitorimit që i përkasin rrjetit të monitorimit në mënyrë të specifikuar të krijuar për çdo komponent mjedisor sic janë ajri, ujrë, toka, biodiversiteti etj.

Stacionet dhe treguesit përzgjidhen në funksion të burimeve të disponueshme por dhe duke përmbushur nevojat e politikbërësve dhe informimin e publikut duke qënë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Secili nga stacionet e monitorimit duhet të jetë i lidhur me një grup të parametrave që maten dhe analizohen, në bazën e të cilave treguesit mjedisorë të cilësisë, presionit dhe ndikimit janë llogaritur, vlerësuar dhe përcaktuar. Përcaktimi i treguesve mjedisorë duhet bërë në bazë të vlerësimit të fizibilitetit të tyre, rëndësisë për kushtet specifike të vendit.

Sistemi i monitorimit është një element shumë i rëndësishëm në arritjen e qëllimit kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit për të kuptuar pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga zhvillimi i projekteve të propozuara në Plan dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative.

Vlerësimi i gjendjes së mjedisit nëpërmjet stacioneve të monitorimit për parametra të ndryshëm vë në pah presionet që i bëhen mjedisit, forcat shtytëse që sjellin ndikimet në mjedis, trendin e treguesve por edhe efikasitetin e politikave mjedisore në përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Kjo është një ndër fazat më të rëndësishme, ku përcaktohen parametrat monitorues, pikat e monitorimit, shpeshësia, mënyra e monitorimit dhe raportimi në institucionet përkatëse. Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura.

Sistemi i monitorimit të ndikimit në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Planit, është një metodë shumë efektive për një monitorim sa më të mirë të mjedisit. Monitorimi i ndikimeve në mjedis është shumë i rëndësishëm për zbatimin e Planit dhe në përputhje me legjislacionin, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim në kohë ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme.

Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversitetin, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Për çdo sektor mjedisor duhet të monitorohen indikatorët përkatëse, duke përcaktuar parametrat mjedisore dhe frekuenca e monitorimit të tyre.

Sistemi i monitorimit duhet të përbëhet nga stacionet e monitorimit që i përkasin rrjetit të monitorimit në mënyrë të specifikuar të krijuar për çdo komponent mjedisor sic janë ajri, ujrat, toka, biodiversiteti etj.

Stacionet dhe treguesit përzgjidhen në funksion të burimeve të disponueshme por dhe duke përmbushur nevojat e politikbërësve dhe informimin e publikut duke qënë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Secili nga stacionet e monitorimit duhet të jetë i lidhur me një grup të parametrave që maten dhe analizohen, në bazën e të cilave treguesit mjedisorë të cilësisë, presionit dhe ndikimit janë llogaritur, vlerësuar dhe përcaktuar. Përcaktimi i treguesve mjedisorë duhet bërë në bazë të vlerësimit të fizibilitetit të tyre, rëndësisë për kushtet specifike të vendit.

Sistemi i monitorimit është një element shumë i rëndësishëm në arritjen e qëllimit kryesor i vlerësimit të gjendjes së mjedisit për të kuptuar pasojat ose ndikimet në mjedis që vijnë nga zhvillimi i projekteve të propozuara në Plan dhe të identifikojë mënyrat për të minimizuar ndikimet negative.

Vlerësimi i gjendjes së mjedisit nëpërmjet stacioneve të monitorimit për parametra të ndryshëm vë në pah presionet që i bëhen mjedisit, forcat shtytëse që sjellin ndikimet në mjedis, trendin e treguesve por edhe efikasitetin e politikave mjedisore në përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Nga ana e subjektit do të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme të gjithë parametrat mjedisorë gjatë fazës së ndërtimit, si dhe gjatë fazës së funksionimit.

Subjekti do të hartojë një regjistër të veçantë për të gjithë parametrat e matur, ku do të shënojë kohën e matur, shpeshësisë si dhe vlerën e gjeneruar.

Këto matje do të jenë të disponueshme për të gjithë autoritetet inspektuese, si dhe do jeni në dijeni institucionet kompetente për gjendjen mjedisore.

### **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

- Cdo veprimtari e zhvilluar nga aktiviteti i njeriut ka ndikim në mjedis dhe në zonën që është propozuar zhvillimi dhe ndërhyrja. E rëndësishme është që për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim.
- Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve të propozuara në Plan, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten për përmirësimin e aseteve materiale si edhe për popullatën ku do të mundësohet integrimi i tyre dhe aktivitete të ndryshme nëpërmjet përshtatjes së infrastrukturës. Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme).
- Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e propozuara. Të gjithë ndërhyrjet në mjedis që do të ndodhin në zonën e prekur nga Plani do të duhet të respektojnë një sërë udhëzuesish për të siguruar që mjedisi të ruajë karakteristikat e tij të identitetit si një vend ku takohen disa njësi peizazhi.
- Lloji i projekteve të propozuara përfshijnë investime në stukturat me funksion si shërbime banimi, akomodimi, argëtimi, tregtare, biznesi, panairë etj. Njësitë e propozuara për zhvillimin e projekteve të propozuara përfshihen në zona urbane dhe ka prani të investimeve të së njëjtës tipologji me llojet e investimeve që lejohen të zhvillohen sipas ndryshimeve të propozuara në Plan.
- Për sa u përket sektorëve mjedisore, asnjë veprim projektues apo menaxhues parashikuar nga Plani nuk gjeneron ndikime negative kumulative apo domethënëse.
- Zonat e propozuara nuk bëjnë pjesë në asnjë kategori të zonave të mbrojtura dhe nuk mbartin vlera kulturore dhe historike për vendin.
- Zonat për ndryshimet e propozuara në Planin e Përgjithshëm Vendor nuk çënojnë në peisazhin dhe integritetin e mjedisit, vihet re mungesë e mjedisit natyror me florë dhe bimësi të vecantë, në këtë zona prania e faunës është shumë ulët, thuhet se është inekzistente.
- Nisur nga vlerësimi i ndryshimeve të propozuara si dhe ndikimet e mundshme gjatë zbatimit të projekteve të propozuara, ndryshimet në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vorë lidhen kryesisht me ndryshimin e sipërfaqes së njësisë dhe llojin e investimeve të lejuara në këto njësi. Nga vlerësimi i ndryshimeve të propozuara nuk priten të

ketë ndryshime të llojit në madhësi të madhe dhe nuk pritet të ketë shumë ndikime, nuk çënohet integriteti i mjedisit natyror, nuk pritet të ketë ndikime në ndryshimet klimatike, nuk çënohen zonat e mbrojtura, si rrjedhojë mendojmë dhe gjykojmë se nga zbatimi i këtij I ndryshimeve të Planit nuk do të ketë ndikime të nivelit të madh dhe të rëndësishëm me pasoja të mëdha.

- Duke qënë se Bashkia Vorë është i pajisur njëherë me Deklaratë Mjediore për Planin e Përgjithshëm Vendor, vlerësojme se nuk është e nevojshme që për ndryshimet e propozuara Bashkia Vorë t'i nënshtrohet edhe njëherë procedurës për VSM, duke theksuar se për cdo projekt që do të zhvillohet në të ardhmen (pas miratimit të këtij Plani), shoqëritë investuese do të bëjnë studimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), e cila siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zonës. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raport për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit.
- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efciente në përdorimin e energjisë, të ndërtimit për çdo objekt të ri, po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Për cdo sektor mjedisor duhet të monitorohen indikatorët përkatëse, duke përcaktuar parametrat mjedisore dhe frekuenca e monitorimit të tyre.

- **Sistemi Urban (Tokat)**

Pergjatë 2 dekadave te fundit, ekonomia shqiptare është transformuar nga një ekonomi kryesisht bujqësore në një ekonomi të dominuar nga shërbimet. Ky transformim ka ndodhur pjesërisht si pasojë e ndryshimeve politike në vend, hapjes së kufijve, dhe rritjes së importit te produkteve agroushqimore, gjë që solli në vecanti një rënie të prodhimit vendas.

Sic dihet, përgjate viteve 90, dhe ndryshimeve te rendesishme ne sistemin qeverises te vendit, pjesa më e madhe e tokave buqësore kaluan në pronësi private. Kjo u realizua me anë të Ligjit nr.7501/91 “Për Tokën”, një ligj i cili gjeti dhe vazhdon të hasë shumë kundërshti.

Njezet vitet e fundit, sistem urban i bashkise Vore ka pesuar ndryshime ne dendesine qytetit, ne hapesiren dhe ne kontestin social. Sot dy dekada pas rënies së regjimit dhe pas kalimit të periudhës më të vështirë të tranzicionit Vora e gjen vetën shumë të ndryshuar me mjaft arritje, probleme por edhe me sfida të mëdha.

Tipologjia territoriale e pozicionimit te parcelave te nderhyrjes evidentohen te jene raste te pozicionimit te parcelave ne inde periferike te qendrave te banuara, kryesisht ne inde te krijuara pas viteve 90, si pasoje e levizjeve demografike me drejtim nga zonat rurale ne qytete. Vendosja e tyre ka ndjekur gjurmet e infrastruktures ekzistuese (pjesa me e madhe e tyre ne zona bujqesore).

Problematika infrastrukture e tilla si: mungesa e infrastruktures se vaditjes, mungesa e infrastruktures rurale, mungesa e kanaleve te kullimit, mungesa e pleherimit te ndikoje ne pjellorine e ketyre tokave, duke i bere te varefra ne prodhim dhe hapesira te disponueshme per ivestime te infrastruktures urbane.

### **Boniteti i Tokes**

Bazuar ne informacionin e shkreses me lendë “Kthim pergjigje” me Nr.191/1 Prot. Nga Keshilli i Qarkut Tiranë Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes se Tokes, dt. 17.02.2023, për shkresen me ane te se se ciles Drejtorina e Planifikimit dhe e Kontrollit te Zhvillimit te Territorit, Bashkia Vore. kerkon percaktimin e kategorise se tokes sipas bonitetit, per pasurite qe preken nga **Rshikimi I Planit te Pergjithshem Vendor.**

*Rezulton se parcelat korrespondojne me kategorine nga III (tre) deri ne VII (Shtate) sipas bonitetit. Per disa te tjera nuk ka informacion.*

***Bashkengjitur do te gjeni dhe Kthim Pergjigjen nga Keshilli i Qarkut Tirane lidhur me Percaktimin e kategorise se tokes sipas bonitetit per pasurite qe preken nga rishikimi i Planit te Pergjithshem Vendor, Bashkia Vore.***

*Hartoi raportin paraprak:*

“GO GREEN STUDIO”

SH.P.K

Administratori:

**Ismet KURTI**





862/1

20.02.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT TIRANË  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS

Nr. 191/1 prot.

Tiranë, më 17.02.2023

Lënda: Kthim përgjigje

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË  
TERITORIT  
BASHKIA VORË

Në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) pranë Këshillit të Qarkut Tiranë janë administruar kërkesa Juaj me nr.862 prot., datë 13.02.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.176 prot., datë 13.02.2023 dhe shkresës me nr.940 prot., datë 16.02.2023 me anë të së cilës keni kërkuar përcaktimin e kategorisë së tokës sipas bonitetit për pasuritë që preken nga rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vorë.

Bazuar në ligjin nr.8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar dhe në VKM nr.121, datë 17.02.2011 "Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna dhe/ose Bashki", ju bëjmë me dije se:

1. Pasuria me nr.25, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(151) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.25 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Arë", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcela është e bonituar, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela rezulton me këtë të dhëna:

Parcela me nr.25 është 69.31 ballë, që korrespondon me *kategorinë - IV (katër)* sipas bonitetit.

2. Pasuria me nr.24, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(151) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.24 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Arë dhe Truall", gjendja deri më 01.08.1991.

Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Ataturk", Tel. (04)42225141, Faks. (04)42223840, e-mail: kryetari@qarkutirane.gov.al



- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcela është e bonituar, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela me nr.24 rezulton e pastudiuar.
3. Pasuria me nr.27, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(151) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.27 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Arë dhe Truall" gjendja deri më 01.08.1991.
    - Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcela është e bonituar, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela me nr.27 rezulton e pastudiuar.
  4. Pasuria me nr.9 dhe nr.20, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(151) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.9 dhe nr.20 të cilat rezultojnë të regjistruara në zërin kadastral - "Arë", gjendja deri më 01.08.1991.
    - Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcelat me nr.9 dhe nr.20 rezultojnë të pastudiuara.
  5. Pasuria me nr.269 dhe 21, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(151) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.269 dhe 21 të cilat nuk rezultojnë brenda kategorisë së resursit të tokës bujqësore (janë tokë truall) dhe për rrjedhojë si të tilla nuk kanë cilësi boniteti.
  6. Pasuria me nr.52; 53 dhe nr.54, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, e ish -N.B "17 Nëntori" Sektori Vorë-Gjokaj, që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelat me nr.52; 53 dhe nr.54 të cilat rezultojnë të regjistruara në zërin kadastral - "Arë", gjendja deri më 01.08.1991.
    - Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcelat me nr.52; 53 dhe nr.54 rezultojnë të pastudiuara.
  7. Pasuria me nr.517, z.k1397, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, e ish -N.B "17 Nëntori" Sektori Vorë-Gjokaj, që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.517 e cila nuk rezulton brenda kategorisë së resursit të tokës bujqësore (është tokë pyll) dhe për rrjedhojë si të tilla nuk kanë cilësi boniteti.
  8. Pasuria me nr.311/, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me

Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Ataturk", Tel. (04)42225141, Fax. (04)42223890, e-mail: kryetari@qarkutirane.gov.al



indeks K34-88-(215) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.311 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Arë", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela me nr.311 rezulton e pastudiuar.

V.O. - Pasuria me nr.311/62 është e studiuar dhe korrespondon me *kategorinë - 7 (shatë)* sipas bonitetit.

Pasuria me nr.311/55 është e studiuar dhe korrespondon me *kategorinë - 5(pestë)* sipas bonitetit.

9. Pasuria me nr.287/3, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të me indeks K34-88-(215) që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.287 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Ullishte", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela me nr.287 rezulton e pastudiuar.

10. Pasuria me nr.1/2, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të ish -"N.B 17 Nëntori" Sektori Marikaj, që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.1 e cila rezulton e regjistruar në zërin kadastral - "Ullishte", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela me nr.1 rezulton e pastudiuar.

11. Pasuria me nr.320/9, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të ish -"N.B 17 Nëntori" Sektori Marqient- Shargë që disponohet në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.104 dhe nr.106 të cilat rezultojnë të regjistruara në zërin kadastral - "Arë", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcela është e bonituar, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcela rezulton me këto të dhëna:

Parcela me nr.104 është 70.78; 78.59 ballë, që korrespondon me *kategorinë - III (tretë)* sipas bonitetit.

Parcela me nr.106 në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë rezulton e pastudiuar.

12. Pasuria me nr.581/, sipas fragmentit të hartës kadastrale me shkallë 1:2500 bashkëlidhur nga ana juaj, në hartën kadastrale me shkallë 1:5000, të ish -"N.B

Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Atatürk", Tel. (04)42225141, Fax. (04)42223890, e-mail: [kyvetari@qarkutirane.gov.al](mailto:kyvetari@qarkutirane.gov.al)

17 Nëntori" Sektori Vorë-Gjokaj dhe hartës kadastrale të ish -N.B "17 Nëntori" Sektori Marikaj (Ullishte) që disponohen në Arkivin e DAMT-së në institucionin tonë, mbivendoset mbi parcelën me nr.103 dhe nr.105 të cilat rezultojnë të regjistruara në zërin kadastral - "Ullishte" dhe parcelën me nr.581 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral - "Truall", gjendja deri më 01.08.1991.

- Për sa i përket kërkesës Tuaj lidhur me faktin nëse parcelat janë të bonituara, ju bëjmë me dije se në bazë të Librit të Bonitetit të Tokës që disponojmë, parcelat me nr.103 dhe nr.105 rezultojnë të pastudiuara.
- Për sa i përket parcelës me nr.581 e cila nuk rezulton brenda kategorisë së resursit të tokës bujqësore (është tokë truall) dhe për rrjedhojë si e tillë nuk ka cilësi boniteti.

Për sa më sipër, nëse jeni të interesuar për kryerjen e studimit të bonitetit, ju sugjerojmë ti referoheni VKM Nr.121 datë 17.02.2011, kreu V, pika 8 dhe 9 (Për tokat bujqësore në të cilat nuk është kryer studimi i bonitetit).


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Mersin MURATAJ



Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Atatürk", Tel. (04)42225141, Fax. (04)42223890, e-mail: [kryetari@qarkutirane.gov.al](mailto:kryetari@qarkutirane.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5026 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 380

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ISMET KURTI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA





NUMRI SERIAL:  
SN-491906-09-17

## ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

**Personit të tatueshëm:**  
Go-Green Studio – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

**Statusi:**  
Aktiv

**Me adresë kryesore:**

Tiranë, Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Margarita Tutulani, Pallati 29, Kati 1, Hyrja 31, Zk 8270, nr.pas. 7/636-N5

**I jepet ky numër identifikimi (NUIS):**  
L62217008P

**Afati i veprimtarisë:**  
Nga: 10/10/2016 deri

**DATA E REGJISTRIMIT**  
17/10/2016

**DATA E LËSHIMIT**  
03-10-2017

**SPORTELI I SHËRBIMIT:**



Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerjet detyrimi ligjor për të qënë person i tatueshëm.

**QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**  
(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të sportelit



**LICENCË**

Numri serial: LN-2235-10-2016  
 NUJIS/NIPT: L62217008P

Subjekti: Go-Green Studio Adresa: Tiranë, TIRANË, Tiranë, TIRANË, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Margarita Tutulani, Pallati 29, Kati 1, Hyrja 31, Zk 8270, nr.pas. 7/636-N5 Kodi: III.2.A (1+2) Data e lëshimit: 12/10/2017 Kod tjetër: Afati i vlefshmërisë: Pa afat	Emërtimi përshkrues i veprimtarisë Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis: Hartim i raporteve të ndikimit në mjedis, kryerje e auditimit mjedisor; Hartimi i ekspertizave mjedisore. Thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të V.N.M. dhe rezultatet e një auditimi mjedisor.
Kategorja Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	Kufizime specifike Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Nënkatëgoria Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	Detyrime specifike Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi
Veprimtari specifike 1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	Vendi i kryerjes së veprimtarisë Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Specialiteti	Nënshkrimi i sportelit: <i>Dajana Stafa</i>



Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerje detyrimi ilgjor për të qenë person i tatueshëm.